

Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

<b>DATË/A:</b>	15.10.2024
<b>REFERENC-Ë:</b>	23/4888/MMPHI
<b>PËR/ZA/TO:</b>	"SharrCem" Sh.p.k. Hani i Elezit, Eksploatim i gurit gëlqeror, Seçishtë, Hani Elezit
<b>CC:</b>	Komisioni për Leje Mjedisore
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	Arkivës së MMPHI-së
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Afrim Murati, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Vendim për refuzimin e kërkesës për t'u pajisur me Leje Mjedisore të Integruar

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për t'u pajisur me Leje Mjedisore të Integruar, të operatorit "SharrCem" Sh.p.k. Hani i Elezit, me nr.prot. 23/4888/MMPHI, për veprimtarinë: Eksploatim i gurit gëlqeror, Seçishtë, Hani Elezit.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Me respekt!



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary*

Nr.: 23/4888/MMPHI  
Datë: 15.10.2024.

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 30 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, nenin 7, paragrafi 5 të Ligjit Nr.08/L-145 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes , nxjerr këtë:

## V E N D I M

Operatorit "SharrCem" Sh.p.k. Hani i Elezit, **i refuzohet** kërkesa për t'u pajisur me Leje Mjedisore të Integruar për veprimtarinë: Eksploatim i gurit gëlqeror, Seçishtë, Hani Elezit, në ngastrat kadastrale sipas Vendimit të Pëlqimit Mjedisor.



## Ar sy e t i m

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar kërkesën për t'u pajisur me Leje Mjedisore të Integruar të operatorit për veprimtarinë: Eksploatim i gurit gëlqeror, Seçishtë, Hani Elezit, në ngastrat kadastrale sipas Vendimit të Pëlqimit Mjedisor.

Kërkesës për t'u pajisur me Leje Mjedisore të Integruar, operatori i ka bashkangjitur dokumentacionin si në vijim:

- Certifikatën e regjistrimit të biznesit, të lëshuar nga MTI;
- Aplikacionin për Leje Mjedisore të Integruar;
- Vendimin e Pëlqimit Mjedisor

MMPHI, ka kërkuar nga kompania plotësimin e dokumentacionit dhe kushteve të cekura më poshtë:


- Licencën e shfrytëzimit nga KPMM
- Planin e vet monitorimi- te plotësohet nga operatori;
- Pagesën tarifës për shqyrtimin e kërkesës për Leje Mjedisore te Integruar sipas Udhëzimit Administrativ Nr.13/2015 ;

Pas shqyrtimit të kërkesës të operatorit në fjalë, duke përfshirë aplikacionin, dokumentacionin shtesë të dërguar që nevojitet për pajisje me Leje Mjedisore të Integruar, MMPHI konstaton se dokumentacioni i dërguar nga operatori, nuk është i kompletuar, pasi që mungon Licenca e shfrytëzimit nga KPMM

Andaj në përputhje me Ligjin Nr.08/L-145 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, MMPHI merre **Vendim që operatorit të lartcekur t'i refuzohet kërkesa për t'u pajisur me Leje Mjedisore të Inegruar.**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.





Afrim Murati

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës-Hani i Elezit;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së